REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVE
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME-MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
AGJENCIA PËR MENAXHIMIN EMERGJENT
AGENCIJA O UPRAVLJANJU VANREDNIM SITUACIJAMA
EMERGENCY MANAGEMENT AGENCY
Nr./Br./No. 301 Nr.fl./Br.str./No.pg. 1/9
Data/Datum/Date 28.10.2025
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova /Ministry of Internal Affairs
Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja/Emergency Management Agency

LISTË DISTRIBUIMI/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		**z. Xhelal Sveçla, Ministër i MPB-së**			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH					
NGA/OD/FROM:		**Genc Metaj, Drejtor Ekzekutiv i AME-së**			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		**Kërkesë, Plani i Përformances 2026**			
Nr. i zyrës: Br. Kancelarije: Office No:	01	Lokacioni: Lokacija: Location:	Dëshmorët e Gollakut, pn. Hajvali	Data: Datum: Date:	28.10.2025

I nderuar z. Ministër,

Në bazë të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe në përputhje me Rregulloren nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore, përmes kësaj kërkese ju drejtohem për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Performancës së Agjencisë për vitin 2026.

Në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, kam themeluar grupin punues brenda institucionit, i cili ka punuar në hartimin e këtij plani, duke u bazuar në objektivat strategjike të Agjencisë dhe në prioritetet qeveritare.

Plani i Performancës përmban objektiva të matshme, si dhe aktivitete konkrete, ngritjen e kapaciteteve. Gjithashtu, janë përcaktuar afatet kohore për realizimin e secilit aktivitet gjatë vitit.

Në këtë drejtim, ju lus që të shqyrtoni dhe të miratoni Planin e Performancës, në mënyrë që Agjencia të mund të vazhdojë zbatimin e tij në përputhje me kornizën ligjore.

Me respekt!

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/ Agencija Emergentnog Upravljanja/Emergency Management Agency

PLANI I PERFORMANCËS
I
AGJENCISË SË MENAXHIMIT EMERGJENT PËR VITIN 2026

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) është organ i pavarur dhe profesional në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e themeluar me Ligjin nr. 04/L-230, i cili rregullon organizimin, strukturimin, detyrat dhe përgjegjësitë e saj. AME ka për detyrë përgatitjen, planifikimin dhe menaxhimin e forcave operative të sistemit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, si dhe koordinimin e aktiviteteve të tyre gjatë emergjencave dhe fatkeqësive të mëdha. Dokumentet strategjike të Agjencisë dhe vizioni i saj i qartë janë të orientuara drejt ndërtimit, ruajtjes dhe ngritjes së sigurisë së përgjithshme, përmes ofrimit të shërbimeve sa më cilësore e profesionale në mbështetje të qytetarëve dhe reaguesve të parë, me qëllim të sigurimit të veprimeve të përbashkëta ekipore për zhvillimin dhe ruajtjen e kapaciteteve të nevojshme në parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje nga të gjitha llojet e fatkeqësive në nivel vendi.

Misioni i AME-së është udhëheqja e përpjekjeve qeveritare në fushën e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri, si dhe organizimi i një sistemi modern të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, i cili, përmes zbatimit me kohë të përgatitjes së të gjitha resurseve në dispozicion të komunitetit, të jetë në gjendje t'u përgjigjet nevojave për shpëtimin e njerëzve, mbrojtjen e të mirave materiale, infrastrukturës kritike, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore gjatë krizave dhe fatkeqësive të ndryshme.

AME është bartëse e një numri të madh detyrash në fushën e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës. Ajo monitoron dhe analizon gjendjen në fushën për të cilën është themeluar, dhe nëpërmjet Ministrit të Punëve të Brendshme i propozon Qeverisë së Republikës së Kosovës masa për përmirësimin e gjendjes dhe drejtimin e zhvillimit të sistemit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës. Në kuadër të Planit të Gatishmërisë Kombëtare, AME, me udhëzime nga Ministri i MPB-

së dhe në bashkëveprim me institucionet vendore, si dhe me mbështetjen e partnerëve të përhershëm të SHBA-së, ka zhvilluar Programin e Ushtrimeve dhe Vlerësimit të Gatishmërisë Kombëtare. Ky program i ofron vendit një platformë të qëndrueshme mbi të cilën institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale mund të zhvillojnë, ruajnë dhe ofrojnë kapacitetet e nevojshme për t'u përballur me të gjitha sfidat e mundshme që mund të burojnë nga natyra apo nga faktori njeri.

Përmes pesë objektivave të përcaktuara për vitin 2026, Agjencia e Menaxhimit Emergjent synon të përmbyllë ciklin e Gatishmërisë Kombëtare, duke hartuar dokumentin strategjik "Qëllimi Kombëtar i Gatishmërisë", nëpërmjet të cilit do të përcaktohen 32 kapacitetet bazë për një vend të sigurt dhe të qëndrueshëm, me aftësinë për t'u përballur dhe për t'u rimëkëmbur me shpejtësi nga çdo lloj rreziku, qoftë ai i shkaktuar nga faktori njeri apo nga natyra.

Ky dokument përcakton objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme me qëllim të zbatimit të një politike efektive gjatë vitit 2026, përfshirë: hartimin dhe plotësim-ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore që burojnë nga ligjet e fushëveprimit të AME-së dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes civile; hartimin e dokumentit "Synimi i Gatishmërisë Kombëtare"; organizimin e Ushtrimit në Shkallë të Gjerë (Ushtrimit Fushor); ngritjen e njësive të Kërkimit-Shpëtimit Urban, Kërkim-Shpëtimit në Ujëra dhe Kërkim-Shpëtimit në Male, sipas standardeve të INSARAG-ut dhe Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile; si dhe avancimin e kapaciteteve reaguese të Njësive Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit.

Fushëveprimi i AME-së buron nga aktet ligjore dhe dokumentet përkatëse, përfshirë: Ligjin nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (04/L-027); Ligjin për zjarrfikje dhe shpëtim (04/L-049); Ligjin për mbrojtje nga zjarri; Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (2010); Planin e Reagimit Kombëtar (2023); Vlerësimin e Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe të tjera në nivel vendi; Strategjinë për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Planin e Veprimit përkatës; si dhe Programin e Ushtrimeve dhe Vlerësimit të Gatishmërisë Kombëtare.

NDIKIMI BUXHETRO NË PLANIN E PËRFORMANCËS 2026

Tabela 1: Planifikimi i buxhetit për 2026

Kodi org.	Institucioni	Numri i aprovuar	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet komunale	Shpenzimet kapitale	Buxheti total
214 - Programi 32700	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	272	2,169,247.00	720,524.00	37,320.00	5,085,000.00	8,012,091,

- Agjencia e Menaxhimit Emergjent ka përgatitur kërkesën buxhetore për vitin 2025
- Kufijtë buxhetor për Agjencia e Menaxhimit Emergjent janë
- Paga dhe Mëditje 2,169,247.00€
- Mallra dhe Shërbime 720,524.00€
- Shpenzime Komunale 37,320.00€
- Shpenzimet Kapitale 5,085,000.00€

Gjithsej buxheti për vitin 2026 : 8,012,091.00 €

KËRKESAT SHTESË +KUFIJT BUXHETOR 2026 QARKORJA E PARË 2026/01				
PËRSHKRIMI	Pershkrimi	Kerkesat shtes 2026	Kufijt buxhetor 2026	Kerkesat shtes +kufitj buxhetor
AME	Personeli	626.00	272.00	898.00
	PAGA DHE SHTESA	13,275,695.44	2,169,247.00	15,444,942.44
	MALLRA DHE SHËRBIME	2,781,212.00	720,524.00	3,501,736.00
	INVESTIME KAPITALE	5,362,153.00	5,085,000.00	10,447,153.00
	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	100,000.00		100,000.00
	KOMUNALI	134,653.00	37,320.00	171,973.00
		21,653,713.44	8,012,091.00	29,665,804.44

A. Pjesa tabelore e Planit të Përformancës

Data		**31/10/2026**				
Agjencia		**AME**				
Ministria përgjegjëse		**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**				
Misioni i Agjencisë		Udhëheqja e përpjekjeve qeveritare në parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe organizimi i sistemit modern të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, sistem i cili përmes zbatimit me kohë të përgatitjes së të gjitha resurseve në dispozicion, të jetë në gjendje t'ju përgjigjet nevojave të shpëtimit të njerëzve, të mirave materiale, infrastrukturës kritike, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore në situata krize, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të shoqërisë moderne.				
Nr.	**Objektivi**	**Treguesit**	**Vlera bazë**	**Vlera e synuar**	**Referenca në dokumente strategjike/politike**	
1.	Hartimi dhe plotësim-ndryshimi i akteve ligjore dhe nënligjore që burojnë nga ligjet e fushëveprimit që e mbulon AME dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes civile	Përmbushja e obligimeve nga Plani Legjislativ të Qeverisë	Planit Legjislativ të Qeverisë	Obligimet e përmbushura	Plani Legjislativ i Qeverise	
		Përmbushja e obligimeve nga Plani Legjislativ për Akte Akteve Nënligjore të MPB-së	Planit Legjislativ të Akte Akteve Nënligjore të MPB-së	Obligimet e përmbushura	Plani Legjislativ i Akteve Nenligjore të MPB-se	
Aktivitetet kryesore		**Njësia përgjegjëse**	**Afati i zbatimit**	**Alokimi financiar**	**Burimi i financimit**	**Rezultatet**
Themelimi i Grupeve të Punës për hartimin e akteve ligjore		MPB/AME	TM 1		AME/Donacion	- Grupet e punës të themeluar

Organizimi i takimeve dhe punëtorive për hartimin e akteve ligjore	Grupi i Punës	TM 1-TM 4	3,500.00	AME/Donacion	- Aktet ligjore të përfunduara
Themelimi i Grupeve të Punës për hartimin e akteve nënligjore	MPB/AME	TM 1		AME/Donacion	- Grupet e punës të themeluar
Organizimi i takimeve dhe punëtorive për hartimin e akteve nënligjore	Grupi i Punës	TM 1-TM 4	5,000.00	AME/Donacion	- Aktet nënligjore të përfunduara
Ndërmarrja e hapave për anëtarësim në Mekaniymin Evropian të Mbrojtjes Civile	DLMNMP	TM 1-TM 4	/	AME/MPB	- Anëtarësimi
Aplikimi aktiv në projektet dhe programet IPA të Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile për avancimin e kapaciteteve të AME-së dhe reaguesve të parë në vend	AME/ DLMNMP/DG	TM 1-TM 4	/	AME/MPB	- Pjesëmarrja në projekte dhe programe
Arrtija e marrëveshjeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore	AME	TM 1-TM 4	/	AME/MPB/MPJD	- Marrëveshjet e arritura
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 1:			**8,500.00**		

Nr.	**Objektivi**	**Treguesit**	**Vlera bazë**	**Vlera e synuar**	**Referenca në dokumente strategjike/politike**	
2.	Hartimi i Dokumentit: Qëllimi Kombëtar i Gatishmërisë	Përmbyllja e Ciklit të Gatishmërisë Kombëtare	Sistemi i Gatishmërisë Kombëtare dhe Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	Dokumenti: Qëllimi Kombëtar i Gatishmërisë i miratuar	– Plani Kombëtar Zhvillimor – Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	
Aktivitetet kryesore		**Njësia përgjegjëse**	**Afati i zbatimit**	**Alokimi financiar**	**Burimi i financimit**	**Rezultatet**

Themelimi i grupit të punës	MPB/AME	TM 1			- Ekipi i Punës i themeluar
Organizimi i puntorive për hartimin e Dokumentit: Qëllimi i Gatishmërisë Kombëtare	Ekipi i Punës	TM 1/TM2	6,500.00	AME/Donacion	- Dokumenti: Qëllimi i Gatishmërisë Kombëtare i përfunduar
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:			**6,500.00**		

Nr.	**Objektivi**	**Treguesit**	**Vlera bazë**	**Vlera e synuar**	**Referenca në dokumente strategjike/politike**
3.	Organizimi i Ushtrimit në Shkallë të Gjerë (Ushtrimit Fushor)	Programi i Ushtrimeve dhe Vlerësimit të Gatishmërisë Kombëtare	Sistgemi i Gatishmëruisë Kombëtare	Identifikimi i përparësive dhe mangësive në kapacitete përballuese	– Programi i Ushtrimeve dhe Vlerësimit të Gatishmërisë Kombëtare (PUVGK)

Aktivitetet kryesore	**Njësia përgjegjëse**	**Afati i zbatimit**	**Alokimi financiar**	**Burimi i financimit**	**Rezultatet**
Themelimi i ekipit të planifikimit	AME/MPB	TM 1			- Ekipi i Punës i Themeluar
Organizimi i Takimit për Koncept dhe Objektiva (TKO)	Ekipi i Planifikimit të Ushtrimit	TM 1	1,500.00	AME	- TKO i përfunduar
Organizimi i Takimit të Parë Planifikues (TPP)	Ekipi i Planifikimit të Ushtrimit	TM 1	2,500.00	AME	- TPP i përfunduar
Organizimi i Takimit Afatmesëm Planifikues (TAMP)	Ekipi i Planifikimit të Ushtrimit	TM 2	3,000.00	AME	- TAMP i përfunduar
Organizimi i Takimit të Fundit Planifikues (TFP)	Ekipi i Planifikimit të Ushtrimit	TM 2	3,500.00	AME	- TFP i përfunduar
Zbatimi i Ushtrimit në Shkallë të Gjerë (USHGJ)	AME/ Ekipi i Planifikimit të Ushtrimit	TM3	15,000.00	AME/Donacion	- Ushtrimi i realizuar

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:				25,500.00		
Nr.	**Objektivi**	**Treguesit**	**Vlera bazë**	**Vlera e synuar**	**Referenca në dokumente strategjike/politike**	
4.	Ngritja e Njësive të Kërkimit - Shpëtimit Urban, Kërkim-Shpërimit në Ujëra dhe Kërkimit - Shpëtimit në Male sipas standardeve të INSARAGUT dhe Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile	Plotësimi i objektivit për gatishmëri të lartë për reagim ndaj emergjencave	Ligji i AME-së dhe Dokumenti Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	Njësia e KSH Urban e ngritur, e pajisur, e trajnuar dhe e gatshme për reagim Njësia e KSH në Ujëra e ngritur, e pajisur, e trajnuar dhe e gatshme për reagim Njësia e KSH Male e ngritur, e pajisur, e trajnuar dhe e gatshme për reagim	- Plani Kombëtar Zhvillimor - Ligji i AME-së - Dokumenti Velrësimi i Rrezikshmrëisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	

Aktivitetet kryesore	**Njësia përgjegjëse**	**Afati i zbatimit**	**Alokimi financiar**	**Burimi i financimit**	**Rezultatet**
Themelimi i Grupit të Punës për ngritjen e Njësive të Kërkim-Spëtimit	Drejtori Ekzekutiv i AME-së	TM 1			- Grupi i Punës i themeluar
Rekrutimi i stafit të Ekipeve	Burimet Njerëzore/AME	TM 1 – TM 4	1,381,073.60		- Stafi i ekipeve i rekrutuar
Organizimi i stafit të Ekipeve	Dep.Gatishmërisë/AME	TM 1 – TM 4	173,190.00		- Stafi i ekipeve i organizuar
Pajisja e stafit të Ekipeve	DFSHP	TM 1 – TM 4	1,803,819.00		- Stafi i ekipeve i pajisur
Trajnimi i stafit të Ekipeve	AME/Qendra e Tranimeve e FSK-së	TM 1 – TM 4	257,550.00		- Stafi i ekipeve i trajnuar

Stërvitja e stafit të Ekipeve		AME/Qendra e Trajnimeve e FSK-së	TM 1 – TM 4	154,800.00		- Stafi i ekipeve i stërvitur
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 4:				**3,770,432.6**		
Nr.	**Objektivi**	**Treguesit**	**Vlera bazë**	**Vlera e synuar**	**Referenca në dokumente strategjike/politike**	
5.	Avancimi i kapaciteteve reaguese-kordinuese të NJPZSH-ve dhe QOER112	Plotësimi i objektivit për gatishmëri të lartë për reagim ndaj emergjencave	Ligji i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit	Standardet e Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim	- Plani Kombëtar Zhvillimor - Ligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim	
Aktivitetet kryesore		**Njësia përgjegjëse**	**Afati i zbatimit**	**Alokimi financiar**	**Burimi i financimit**	**Rezultatet**
Investime kapitale ne Infrastrukture ndertimore te objketeve		DFSHP/AME	TM 1 – TM 4	1,000,000.00	AME	- Objektet e ndërtuara per AME,NJPZSH dhe QOER 112
Investimet kapitale automjete per zjarrfikje dhe shpetim		DFSHP/AME	TM 1 – TM 4	1,780,048.00 €	AME	- NJPZSH-të e pajisura
Avancimi i sistemit te komunikimit dhe dixhitalizimit		DFSHP/AME	TM 1 – TM 4	400,000.00	AME	- NJPZSH-të e pajisura
Investime kapitale ne paisje personale dhe paisje te përbashkëta		DFSHP/AME	TM1-TM4	1,904,952.00 €	AME	- NJPZSH-të e pajisura
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 5:				**5,085,000.00**		

Genc Metaj

Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë

Xhelal Sveçla

Ministër i MPB-së